



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 435/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur lidhur me ankesën subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), me seli në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar, e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me nr. A-435 e datës 11.12.2010 kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD).

Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2250 (dymijë e dyqind e pesë dhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Subjekti politik PDK, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik LDD, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, në ankesë theksohet se më datë 10.12.2010 në ora 16:00 në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj, është vërejtur se subjekti politik LDD ka vendosur posterat e kandidatitve për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi ata të PDK-së, lidhur me fushatën zgjedhore

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 11.12.2010, nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se subjekti politik LDD ka vendosur posterat mbi ata të PDK-së lidhur me fushatën zgjedhore e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilat shihet qartë se posterat e subjektit politik LDD, është vendosur mbi ata të PDK-së.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik LDD, më datë 12.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 13.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigjeje në ankesë nga

subjekti politik LDD, sipas afatit të caktuar për të sqaruar lidhur me shkeljen e pretenduar.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (b) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim:

b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose hapësirave private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posteri i subjektit politik LDD është i vendosur mbi ata të PDK-së në rrugën “Dëmorët e Kombit” në Ferizaj, nga kjo arsye dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartë cekur po ashtu në pajtim me dispozitat e

Iart cekura ligjore PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

A nr. 435/2010 më datën 23.12.2010

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

